



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për vetëqeverisjen lokale, nr. 03/L-040, Ligjin e Punës nr. 03/L-212 dhe Rregulloren (QRK) për përcaktimin e orarit të punës dhe pushimet e zyrtarëve publik nr.12/2020, merr:

V E N D I M

Neni 1

1.Orari i punës për nëpunësit publik të Administratës komunale sipas rregullit fillon nga ora 8.00, dhe përfundon në orën 16.00, ndërsa pauza prej orës 12.00 – 13.00, dhe atë pesë ditë në javë, nga dita e hënë deri në ditën e premte.

2.Me qëllim të krijimit të kushteve për ofrim të pandërprerë të shërbimeve për qytetarë, sektorët dhe shërbimet përkatëse të punëve me palë, riorganizojnë punën dhe orarin e punës, në mënyrë që këto shërbime të kryhen pa ndërprerë nga ora 8:00 deri në orën 16:00.

Neni 2

Drejtorët e Drejtorive përkatëse në bashkëpunim me Zyrën e Personelit bëjnë riorganizimin e orarit të punës sipas paragrafit 2 të nenit 1 të këtij vendimi.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nxjerrjes.

I dërgohet:

*Drejtorëve të Drejtorive
Menaxherit të Personelit
Arkivit*


Nr. prot. 02-104/03-0074521/20
Podujevë, 08 dhjetor 2020

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





KOMUNA E PODUJEVËS - REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVO KOMUNALNA UPRAVA - OPŠTINA PODUJEVO / MUNICIPALITY OF PODUJEVO DIREKTORJA E ADMINISTRATËS - UPRAVA ADMINISTRACIJE		
Bazuar në 11.12.2020		
Numri i dokumentit	Nr. Br.	Shtojcë - Prilog
02-370/03-00754/02	-1-	
PODUJEVO - PODUJEVO		



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republik of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040 dhe nenin 16 të Statutit të Komunës së Podujevës nr. 01-020/01-0050862/18, Kryetari i Komunës, nxjerr:

URDHËRESË

I.

Urdhërohen menaxherët e kontratave të Prokurimit që n'cilësinë e organit mbikëqyrës të projekteve kapitale të Komunës së Podujevës dhe projekteve tjera në bashkëfinancim që janë në proces të realizimit, për vendosjen e tabelave sipas modelit bashkëngjitur në këtë urdhëresë, me përmbajtje:

- Logoja e Komunës
- Emri i investitorit/ve
- Emri i operatorit ekonomik
- Emri i projektit
- Vlera e projektit/kontratës
- Emri i menaxherit të projektit/kontratës
- Plani dinamik

Ky aktivitet të kryhet në koordinim me Zyrën e Prokurimit brenda në një periudhe kohore sa më të shpejtë.

II.

Vendosja e tabelave bëhet me qëllim të fuqizimit të transparencës komunale dhe llogaridhënies për qytetarët e Komunës së Podujevës dhe grupeve të interesit në mënyrë që punimet dhe projektet përkatëse të jenë të qasshme për publikun.

III.

Urdhëresa hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet menaxherëve të kontratave të projekteve kapitale, përmes Menaxherit të Prokurimit

Podujevë, 11 dhjetor 2020





Republika e Kosovës/Republika Kosova/Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës/Opština Podujevo/Municipality of Podujeva



INVESTITORI: KOMUNA E PODUJEVËS

OPERATORI EKONOMIK:

EMRI I PROJEKTIT:

VLERA E PROJEKTIT: MENAXHERI I PLANI DINAMIK:
PROJEKTIT:

.....



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 17 shkronja h) të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr. 03/L-040, nenet 53.1 ; 55.1 dhe 58 të Ligjit për procedurën e përgjithshme administrative nr. 05/L-031 dhe Udhëzimin Administrativ (MASHT) nr. 15/2019 për detyrat përgjegjësitë dhe kriteret e zgjedhjes së drejtorit dhe zëvendësdrejtorit të institucionit publik edukativo-arsimor dhe aftësues parauniversitar, merr:

V E N D I M

Neni 1

1. Anulohen të gjitha vendimet e datës 01.12.2020 lidhur me emërimet e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve të shkollave fillore, të mesme të ulëta dhe të mesme të larta, si dhe aktet tjera të nxjerra sipas konkursit të Drejtorisë së Arsimit nr. 05-306, datë 22.07.2020.

2. Të njëjtit/at emërohen ushtrues/e detyre të drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve në shkollat përkatëse konform nenit 35.5 të Ligjit nr. 04/L-032 për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe nenit 3.11 të U.A. 15/2019, deri në emërimin e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve sipas konkursit publik në pajtim me rregullat dhe procedurat ligjore në fuqi.

Neni 2

Anulimi i vendimeve dhe akteve sipas paragrafit 1 të nenit 1 të këtij vendimi bëhet për shkak të tejkalimit të afateve ligjore të emërimit të drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve të përcaktuara sipas Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr. 15/2019, *(neni 3 me theks paragrafi 11)*.

Neni 3

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Arsimit e cila po ashtu obligohet për shpalljen e konkursit publik për zgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve në institucionet edukativo arsimore të Komunës.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

I dërgohet:


Drejtorisë së Arsimit

Të emëruarve U.D. të drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve të shkollave (përmes Drejtorisë së Arsimit)

Arkivit

Nr. prot. 02- 020/02-0075287/20
Podujevë, 11 dhjetor 2020

Kryetari i Komunës
Shpejta Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, nenin 16 dhe 61 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18, duke u bazuar në masat e Qeverisë së Republikës së Kosovës të ndërmarra më 11.03.2020 për parandalimin e përhapjes së Coronavirusit COVID-19, dhe Vendimin nr.prot.01/42 të datës 11 nëntor 2020 të Qeverisë së Republikës së Kosovës për masat e përgjithshme dhe specifike për mbrojtjen nga pandemia Covid-19, merr këtë,

VENDIM

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR VEPRIME DHE MASA KUNDËR VIRUSIT EPIDEMIK COVID19 (SHTABI EMERGJENT)

Neni 1

Formohet komisioni i veçantë ad-hoc për ndërmarrjen e veprimeve dhe masave preventive në funksion të parandalimit të përhapjes së virusit epidemik COVID-19, në territorin e Komunës së Podujevës, në përbërje:

- | | |
|--|-----------|
| 1. Shpejtim Bulliqi , <i>Kryetari i Komunës</i> , | kryesues, |
| 2. Marigona Lahu , <i>Nënkryetare e Komunës</i> , | anëtare |
| 3. Egzona Mustafa-Gashi , <i>U.D. drejtore e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale</i> , | anëtare |
| 4. Ymer Llugaliu , <i>nga Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare - QKMF</i> , | anëtar |
| 5. Bedrie Rama , <i>epidemiologe, në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare</i> , | anëtare |
| 6. Bahri Selimi , <i>U.D. drejtor i Drejtorisë së Administratës</i> , | anëtar |
| 7. Fevzi Jetullahu , <i>U.D. drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit</i> , | anëtar |
| 8. Ajet Potera , <i>U.D. drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit</i> , | anëtar |
| 9. Isak Ejupi , <i>Komandanti i Stacionit të Policisë - Podujevë</i> , | anëtar |
| 10. Avni Fetahu , <i>drejtor i Drejtorisë së Arsimit</i> , | anëtar |
| 11. Mensur Hoti , <i>kryetar i Këshillit të Bashkësisë Islame – Podujevë</i> , | anëtar |
| 12. Vail Shala , <i>Kryqi i Kuq i Kosovës – Sekretar në Degën Podujevë</i> , | anëtar |

Neni 2

Komisioni ndërmerr veprime dhe masa e nevojshme në përputhje me Vendimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës, dhe në përputhje me Udhëzimet e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë lidhur me masat preventive për parandalimin e përhapjes së epidemisë COVID-19, si dhe veprime dhe masa tjera varësisht situatave eventuale të krijuara.

Neni 3

Vendimi hyn ditën e nënshkrimit, ndërsa shfuqizohen Vendimi nr.prot. 02-020/04-0019708/20 dt. 13 mars 2020 dhe Vendimi nr.prot. 02-020/04-0063043/20 dt.19 tetor 2020,

U dërgohet:

Anëtarëve të Komisionit dhe mekanizmave relevant të nivelit qendror dhe lokal.

Nr.02-020/04-0075461/20
Podujevë, 11 dhjetor 2020

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenin 49 parag. 1 të Ligjit për Zyrtarët Publik nr. 06/L-114, nenin 10 të Rregullores (QRK) nr. 11/2020 për disiplinën dhe ankesat e zyrtarëve publik dhe nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-50862/18, nxjerr:

VENDIM PËR THEMELIMIN DHE PËRBËRJEN E KOMISIONIT DISIPLINOR

Neni 1

1. Themelohet Komisioni disiplinor në administratën publike të Komunës së Podujevës.
2. Përbërja e komisionit është:

Arsim Mehmeti , <i>udhëheqës i sektorit të kadastrit,</i>	kryesues
Mirlinda Arifi , <i>zyrtare ligjore në Drejtorinë e Arsimit,</i>	anëtare
Jehona Havolli , <i>zyrtare në zyrën e personelit,</i>	anëtare

Neni 2

Funksioni dhe përgjegjësitë e Komisionit janë të përcaktuara me dispozitat e Ligjit për Zyrtarët Publik nr. 06/L-114 dhe aktet nënligjore që i referohen fushës së veprimit të këtij ligji.

Neni 3

Komisioni themelohet në mandat tre vjeçar.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit, ndërsa shfuqizohet Vendimi për themelimin dhe përbërjen e komisionit disiplinor me nr. prot. 02-020/04-0086459/19, datë 06 nëntor 2019.

I dërgohet:
Anëtarëve të komisionit
Zyrës së Personelit
Arkivit

Nr. 02-020/04-0075419/20
Podujevë, 14 dhjetor 2020





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 13, 17 shkronja f) dhe 58 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040, nenin 5.2 (i) të Ligjit për Ndërmarrjet Publike, nr.03/L-087, nenin 23 (Lista 2 – Stacionet e Autobusëve, nr.2) të Ligjit nr.04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr.03/L-087, neneve 16, 19 paragrafi 1.6 dhe 61 paragrafi 1.3, të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-020/01-0050862/18, dhe sipas nenit 1 paragrafi 2 të Vendimit nr. 01-020/04-0007443/20 për ngritjen e Komisionit Komunal të Aksionarëve në Ndërmarrjen Publike - Kompania Regjionale e Mbeturinave “Pastrimi” sh.a, të miratuar nga Kuvendi i Komunës së Podujevës, më 31 janar 2020,

VENDIM

PËR EMËRIMIN E ANËTARIT NË KOMISIONIN KOMUNAL TË AKSIONARËVE TË NDËRMARRJES PUBLIKE – KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE “PASTRIMI” SH.A.

Neni 1

Anëtar i Komisionit Komunal të Aksionarëve në Ndërmarrjen Publike - Kompania Regjionale e Mbeturinave “Pastrimi” sh.a, emërohet,

z.Fevzi Jetullahu, U.D. drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit

Neni 2

Detyrat dhe përgjegjësit e Komisionit, përkatësisht anëtarit të emëruar, janë të përcaktuara me dispozitat e Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr.03/L-087, Ligjin nr.04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr.03/L-087, Ligjin nr.05/L-009 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike i Ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin nr.04/L-111, dhe Ligjin për Shoqëritë Tregtare.

Neni 3

Ky Vendim është pjesë përbërëse e Vendimit të Kuvendit të Komunës, nr. 01-020/04-0007443/20 të datës 31 janar 2020.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit, ndërsa shfuqizohet vendimi nr.prot.02-020/05-0014978/20 i datës 24 shkurt 2020

*U dërgohet;
Të emëruarit
Anëtarëve të Komisionit
Arkives*

Nr.02-020/04-0076122/20
Podujevë, 16 dhjetor 2020





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, Rregulloren nr. 01/2020 për sistemin e menaxhimit të performancës komunale dhe skemës së grantit për performancë komunale dhe neneve 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës, nr.01-020/01-0050862/18, Kryetari i Komunës, nxjerr;

V E N D I M

PËR EMRIMIN E KOORDINATORIT DHE ZYRTARËVE PËR ADMINISTRIMIN E SISTEMIT PËR MENAXHIMIN E PERFORMANCËS NË KOMUNËN E PODUJEVËS

Neni 1

Për administrimin e Sistemit për Menaxhimin e Performancës në Komunën e Podujevës, emërohen koordinatori dhe zyrtarët komunal, në përbërje:

- | | | |
|------------------------|-------------|--|
| 1. Ejup Babatinca, | koordinator | |
| 2. Makfirete Zeka | anëtare | (Kujdesi primar shëndetësor) |
| 3. Liridona Rrahmani, | anëtare | (Transparenca komunale) |
| 4. Enis Sheholli | anëtar | (Shërbimet publike Administrative; Përgjegjshmëria komunale) |
| 5. Arbëresha Bashota, | anëtare | (Barazia në punësim; Përfaqësimi gjinor) |
| 6. Vedat Muçolli, | anëtar | (Kulturë, rini dhe sport) |
| 7. Kujtim Zhitia | anëtar | (Menaxhimi i fatkeqësive) |
| 8. Florie Mani, | anëtare | (Planifikimi hapësinor) |
| 9. Rizah Muçolli, | anëtar | (Hapësirat publike; Menaxhimi i mbeturinave; Mbrojtja e ambientit) |
| 10. Doruntinë Sollova, | anëtare | (Infrastruktura rrugore) |
| 11. Afrim Mulliqi, | anëtar | (Transporti publik; Parkingjet publike) |
| 12. Naser Kajtazi, | anëtar | (Uji i pijshëm) |
| 13. Granit Hasani, | anëtar | (Kanalizimi) |
| 14. Ardian Emini, | anëtar | (Arsimi parauniversitar) |
| 15. Memli Gashi, | anëtar | (Zhvillimi ekonomik lokal) |

Neni 2

Detyrat dhe përgjegjësitë e koordinatorit dhe zyrtarëve janë të përcaktuara në dokumentin-Sistemi për Menaxhimin e Performancës komunale të MAPL.

Koordinatori dhe zyrtarët janë përgjegjës sipas fushave të përcaktuara në nenin 1 të këtij vendimi.


Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit, ndërsa shfuqizohet Vendimi nr. prot. 02-020/04-0055357/20, datë 15 shtator 2020 për emërimin e koordinatorit dhe zyrtarëve për administrimin e Sistemit për Menaxhimin e Performancës në Komunën e Podujevës.

*U dërgohet;
Të emëruarve
Arkivës*

Nr.02-020/04-0076160/20
Podujevë, 16 dhjetor 2020

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republik of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040 dhe nenin 16 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-020/01-0050862/18, Kryetari i Komunës, nxjerr:

U R D H Ë R E S Ë

I.

1.Kërkohet nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale-DSHMS dhe Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare-QKMF Podujevë, që në mënyrë permanente të përcjellin procesin e furnizimit të barërave dhe materialeve tjera mjekësore dhe të përkujdesen në administrimin strikt të tyre përmes një sistemi monitorues sa i përket regjistrimit, shpërndarjes dhe çështjeve tjera përkatëse, varësisht nevojave dhe kërkesave, në përputhje me rregullativën ligjore.

2.Çdo pranim dhe dorëzim apo shpërndarje e barërave dhe materialeve tjera mjekësore të evidentohen në regjistrat përkatës/data bazë.

II.

Për çdo lëshim eventual nga ana e zyrtarëve/personelit përgjegjës do të merren masa disiplinore dhe masa tjera ligjore.

III.

Për zbatimin e Urdhëresës kujdesen Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare-QKMF Podujevë.

IV.

Për punët dhe detyrat sipas kësaj Urdhërese kërkohen raporte sistematike të detajuara. Raportet paraqiten në Zyrën e Kryetarit të Komunës përmes Drejtores së Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

V.

Urdhëresa hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:

Drejtores së DSHMS-së

U.D. Drejtorit të QKMF-së

Zyrtarëve/personelit përkatës vartës

Arkivit

Nr.02-500/04-0076976/20
Podujevë, 21 dhjetor 2020

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 13 dhe 17 shkronja s), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, dhe neneve 16 dhe 19 parag. 1.18, 1.19 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862/18 të datës 29 qershor 2018, merr,

VENDIM PËR NGRITJEN E KOMISIONIT PËR PËRZGJEDHJEN E SPORTISTIT TË VITIT 2020 DHE SPORTISTËVE TË TJERË TË DALLUAR NË KOMUNËN E PODUJEVËS

Neni 1

Për përzgjedhjen e sportistit të vitit 2020 dhe sportistëve të tjerë të dalluar në Komunën e Podujevës, ngritet komisioni në këtë përbërje:

- | | |
|-------------------------------------|----------|
| 1. Emin Ajvazi, | kryesues |
| 2. Isak Qosa, | anëtar |
| 3. Luljeta Zhegrova - Shala, | anëtare |
| 4. Naim Lepaja, | anëtar |
| 5. Vedat Muçolli, | anëtar |

Neni 2

Komisioni bën vlerësimin e propozimeve të Klubeve Sportive dhe në bazë të sukseseve dhe rezultateve të arritura në gara vendore dhe ndërkombëtare, bënë përzgjedhjen e sportistit të vitit dhe sportistëve tjerë të dalluar.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit-DKRS, Podujevë.

Neni 4


Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

*I'u dërgohet
DKRS
Anëtarëve të komisionit
arkivit*

**Nr.02-020/04-0077006/20
Podujevë,
21 dhjetor 2020**

**Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi**





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040 dhe nenit 16 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862/18, nxjerr:

V E N D I M

Neni 1

1.Hapësira në pjesën e përparme brenda oborrit të ndërtesës së re të Komunës lejohet për shfrytëzim të parkingut të automjeteve me targa të huaja nga bashkatdhetarët të cilët qëndrojnë për pushime në Komunën e Podujevës, dhe jo vetëm.

2.Hapësira lejohet për shfrytëzim 24 orë dhe atë pa pagesë.

Neni 2

Për zbatimin e vendimit kujdeset Drejtoria e Administratës e cila organizon dhe cakton personelin përkatës për mbarëvajtjen e procesit sipas nenit 1 të këtij vendimi.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe vlen deri më 05.01.2021.

U dërgohet:

Drejtorisë së Administratës


Zyrës për Marrëdhënie me Publikun dhe Informim

Arkivit

Nr. 02-346/06-0077606/20
Podujevë, 22 dhjetor 2020

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale, nr. 03/L-040, nenin 16 të Statutit të Komunës, nr. 01-020/01-0050862/18, si dhe në pajtim me Ligjin nr. 04/I-022 për përdorim civil të eksplozivëve, nxjerr:

URDHERESË PËR NDALIMIN E PËRDORIMIT TË MJETEVE PIROTEKNIKE

I

NDALOHET përdorimi i mjeteve piroteknike/eksplozivëve në sheshe, rrugë, tregje dhe hapësira tjera publike në territorin e Komunës së Podujevës.

II

Ndalesa sipas pikës I të kësaj urdhërese vlen për periudhën 22 dhjetor 2020 deri më 03 janar 2021.

III

Personat të cilët veprojnë në kundërshtim me dispozitat e kësaj urdhërese do të gjobiten në shumë prej 100 €.

IV

Për zbatimin e kësaj urdhërese kujdeset Drejtoria e Inspektionit.

V

Urdhëresa hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*U dërgohet:
Drejtorisë së Inspektionit
Zyrës për Marrëdhënie me Publikun
Arkivit*

**Nr. 02-016/01-0077547/20
Podujevë, 22 dhjetor 2020**

**Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi**





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, Rregulloren (QRK) nr.12/2020 Për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë dhe nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.7 të Statutit të Komunës së Podujevës nr. 01-020/01-0050862/18, nxjerr:

V E N D I M

Neni 1

Shërbimet e Komunës, fushëveprimi i të cilave ka të bëjë me ofrimin e shërbimeve për qytetarë, angazhohen të punojnë edhe gjatë ditëve të vikendit, ditën e shtunë dhe të diel.

Neni 2

Organizimi i punës dhe angazhimi i stafit bëhet nga Drejtorët e Drejtorive përkatëse në bashkëpunim me Zyrën e Personelit, në përputhje me kushtet dhe kriteret e parapara me Rregulloren (QRK) nr.12/2020 Për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë.

Neni 3

Angazhimi i shërbimeve sipas këtij vendimi bëhet për shkak të rritjes së vëllimit të kërkesave dhe punëve me rastin e ardhjes së bashkatdhetarëve tanë nga diaspora.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe vlen deri më 08.01.2021.

U dërgohet:
Drejtorëve të Drejtorive
Zyrës së personelit
Arkivit

Nr. 02-016/01-0077805/20
Podujevë, 23 dhjetor 2020





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 13 dhe 17 shkronja s), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, dhe neneve 16 dhe 19 paragrafët 1.18; 1.19 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862/18 të datës 29 qershor 2018, merr,

VENDIM

Neni 1

Për vlerësimin dhe përzgjedhjen e punimeve të krijuesve në aktivitetin letrar **Takimet e Kulturës “Kadri Kadriu” – 2020**, në fushat; Poezi, Ese dhe Tregim i Shkurtër, sipas konkursit letrar të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit, publikuar më 14.12.2020, ngritet komisioni në këtë përbërje:

1. **Abdullah Blakçori**, *Prof. i Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe*, kryesues
2. **Isuf Sadriu**, *Prof. i Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe*, anëtar
3. **Blerim Zhitia**, *Prof. i Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe*, anëtar

Neni 2

Komisioni bën vlerësimin dhe përzgjedhjen e punimeve letrare në fushat sipas këtij vendimi në përputhje me kriteret e konkursit përkatës, si dhe përgatit raportin në formë të shkruar i cili i paraqitet Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit - DKRS.

Neni 4

Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet;

DKRS

*Anëtarëve të komisionit, përmes DKRS-së
arkivit*

Nr.02-020/04-0078009/20
Podujevë,
23 dhjetor 2020





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13, 17 shkronja m) dhe 58 shkronja g) të Ligjit për vetëqeverisjen lokale, nr. 03/L-040, nenet 16, 19 paragrafi 1.13 dhe 61 paragrafi 1.7 të Statutit të Komunës, nr. 01-020/01-0050862/18, nxjerr:

U R D H Ë R E S Ë

I

OBLIGOHET i tërë personeli i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare duke përfshirë edhe Qendrat e Mjekësisë Familjare dhe Ambulantat e Mjekësisë Familjare në territorin e Komunës së Podujevës, varësisht punëve dhe detyrave të përcaktuara nga vendi i punës që mbajnë, që konform rregullativës përkatëse ligjore;

- **Të respektojnë detyrat dhe përgjegjësitë e punës;**
- **Të respektojnë orarin e punës;**
- **Të respektojnë kodin e mirësjelljes dhe kodin e veshjes;**
- **Të ngitet niveli i higjienës në të gjitha objektet shëndetësore**

II

Obligohen U.D. Drejtori i QKMF-Podujevë dhe përgjegjësit e njësive tjera (QMF, AMF) që të ndërmarrin të gjitha masat dhe veprimet e nevojshme për respektimin e kësaj Urdhërese, në të kundërtën do të ndërmerren masa disiplinore dhe masa tjera përkatëse ligjore.

III

Për mbikëqyrjen e zbatimit të kësaj Urdhërese, pa përjashtuar edhe rregulla dhe përgjegjësi tjera të parapara me rregullativë ligjore, obligohet Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

IV

Urdhëresa hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:
Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
U.D. drejtorit të QKMF-së
Zyrës për Marrëdhënie me Publikun dhe Komunikim
Arkivit

Nr. 02-500/01-0078164/20
Podujevë, 24 dhjetor 2020

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11 dhe 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, neneve 14 dhe 16 të Statutit të Komunës nr. prot. 020/01/0050862/18 si dhe Raportit të Zyrës Kombëtare të Auditimit për pasqyrat financiare të Komunës së Podujevës për vitin financiar të përfunduar më 31 dhjetor 2019, merr:

V E N D I M

PËR CAKTIMIN E KOORDINATORIT TË PROCESIT PËR ÇËSHTJET AUDITUESE DHE GRUPIT PUNUES PËR OFRIMIN E KOMENTEVE NË BAZË TË LISTËS SË OFRUAR NGA KOORDINATORI I PROCESIT

- I. Caktohet Koordinatori i Procesit-KP për çështje audituese dhe formohet Grupi Punues-GP për zbatimin e Planit të Veprimit të datës 16.07.2020, për zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga Zyra Kombëtare e Auditimit për Komunën e Podujevës për vitin 2019, në këtë përbërje:
1. **Fatlum Osmani**, Drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave – Koordinator i Procesit dhe kryesues i Grupit Punues.
 2. **Bahri Selimi**, Drejtor i Drejtorisë së Administratës, anëtar.
 3. **Fevzi Jetullahu**, Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, anëtar.
- II. Koordinatori i Procesit dhe Grupi Punues kanë për detyrë të operojnë në përputhje me Procedurat Standarde të Operimit (PSO)- trajtimi i të gjeturave dhe zbatimi i rekomandimeve të auditimit të jashtëm dhe të brendshëm nga Subjekti i Sektorit Publik i audituar, aprovuar nga Ministria e Financave.
- III. Për punën e kryer Koordinatori i Procesit e njofton në formë të shkruar Zyrën e Kryetarit të Komunës.
- IV. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dorëzohet:

Koordinatorit të procesit

Anëtarëve të Grupit Punues

Arkivit

Nr. prot.02-020/04-0079709/20
Podujevë, 30 dhjetor 2020

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 13, 17 shkronja f) dhe 58 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040, nenin 5.2 (i) të Ligjit për Ndërmarrjet Publike, nr.03/L-087, nenin 23 (Lista 2 – Stacionet e Autobusëve, nr.2) të Ligjit nr.04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr.03/L-087, neneve 16, 19 paragrafi 1.6 dhe 61 paragrafi 1.3, të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-020/01-0050862/18, dhe sipas nenit 1 paragrafi 2 të Vendimit nr.01-020/04-0037950/19 për ngritjen e Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Stacioni i Autobusëve Podujevë, të miratuar nga Kuvendi i Komunës së Podujevës, më 08 maj 2019, merr,

VENDIM PËR EMËRIMIN E ANËTARIT NË KOMISIONIN KOMUNAL TË AKSIONARËVE TË NDËRMARRJES PUBLIKE STACIONI I AUTOBUSËVE PODUJEVË

Neni 1

Anëtar i Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Stacioni i Autobusëve Podujevë, emërohet,

z. Bahri Selimi, Drejtor i Drejtorisë së Administratës

Neni 2

Detyrat dhe përgjegjësit e Komisionit, përkatësisht anëtarit të emëruar, janë të përcaktuara me dispozitat e Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr.03/L-087, Ligjin nr.04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr.03/L-087, Ligjin nr.05/L-009 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike i Ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin nr.04/L-111, dhe Ligjin për Shoqëritë Tregtare.

Neni 3

Ky Vendim është pjesë përbërëse e Vendimit të Kuvendit të Komunës, nr.01-020/04-0037950/19 të datës 08 maj 2019.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit, ndërsa shfuqizohet Vendimi me nr.prot.02-020/05-0053552/19 i datës 03 korrik 2019.

*U dërgohet;
Të emëruarit
Anëtarëve të Komisionit
Arkives*

**Nr.02-020/04-0000843/21
Podujevë, 06 janar 2021**





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
